

RAPORT MONITORIMI I POLITIKËS

Parandalimi i
Ngacmimeve
Online dhe
Çështjeve të
Lidhura me
Hapësirën
Dixhitale

Komuna e Mitrovicës

Autore: Lejla Leci

Rishikues: KYC Kosova

Dizajni: Sh.P.K. "SUKI"

"Social Urban Innovation Kosova"

Të drejtat e autorit © 2025. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

Parandalimi i Ngacmimeve Online dhe Çështjeve të Lidhura me Hapësirën Dixhitale

Rasti Shembull - Komuna e Mitrovicës



Ky raport u realizua me mbështetjen financiare të Unicef Kosovo Programme, IOM Kosovo dhe Peacebuilding Fund, si produkt i iniciativës së implementuar nga KYC Kosova dhe Këshilli i Nxënësve të Mitrovicës.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin medoemos qëndrimet e autorëve/rishikuesve, KYC-it apo të donatorëve.

Hyrje

Ngacmimi online (cyberbullying) dhe çështjet e tjera të lidhura me hapësirën dixhitale janë probleme në rritje që ndikojnë negativisht në mirëqenien emocionale dhe sociale të nxënësve, veçanërisht në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ku diversiteti etnik dhe qasja në teknologji mund të krijojnë sfida shtesë. Mungesa e politikave efektive për parandalimin dhe adresimin e këtyre fenomeneve mund të çojë në rritjen e tensioneve, izolimin e nxënësve dhe pasoja afatgjata në zhvillimin e tyre. Krijimi i një mjedisi arsimor të sigurt, si në hapësirën fizike ashtu edhe në atë online, është thelbësor për të mbrojtur nxënësit dhe për të promovuar një shoqëri të shëndetshme.

Ky monitorim ka dy qëllime kryesore:

1. Të analizojë nëse politikat ekzistuese për parandalimin e ngacmimit online dhe çështjeve të tjera dixhitale janë të qarta dhe zbatohen në praktikë në Komunën e Mitrovicës së Jugut, duke u fokusuar te ndikimi te nxënësit nga komunitetet e ndryshme.

2. Të japë rekomandime konkrete për forcimin e mekanizmave kundër ngacmimit online, rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e sigurisë dixhitale në shkolla.

Gjetjet e këtij monitorimi do të ndihmojnë shkollat, Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), politikëbërësit dhe palët e interesit për të ndërmarrë hapa më efektive për të krijuar një mjedis arsimor të sigurt dhe të mbështetur në hapësirën dixhitale për të gjithë nxënësit.

Analizimi i ligjeve dhe politikave ekzistuese

Për analizën e gjendjes aktuale do të merren parasysh këto dokumente:

- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Kosovë (për të vlerësuar masat për sigurinë e nxënësve)
- Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (për të analizuar mbrojtjen nga diskriminimi online)
- Strategjia e Arsimit 2022-2026 (me fokus në objektivat për sigurinë dhe gjithëpërfshirjen dixhitale)
- Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (për të vlerësuar privatësinë dhe sigurinë online të nxënësve)
- Statistikat në Arsim (2022-2023 dhe 2023-2024) (për të analizuar raportimet e incidenteve të ngacmimit online)
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (nenet për të drejtat themelore dhe mbrojtjen nga diskriminimi)
- Udhëzimi Administrativ Nr. 6/2014 i MASHT-it, Kodi i Mirësjelljes dhe Masat Disiplinore për Nxënës të Shkollave të Mesme të Larta
- Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2023-2027
- Studime të tjera nga organizata vendore dhe nderkombëtare

Rezultatet

Politikat ekzistuese në Kosovë nuk ofrojnë mekanizma të qartë dhe specifike për parandalimin dhe raportimin e ngacmimit online në shkolla. Ligji për Arsimin Parauniversitar fokusohet në mbrojtjen e nxënësve nga fjalët dhe veprimet fyese, por nuk e përmend shprehimisht ngacmimin online. Po ashtu, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve adreson diskriminimin, por nuk përfshin drejtpërdrejt çështjet e cyberbullying.

Megjithatë, Strategjia e Arsimit 2022-2026 synon të integrojë elemente të sigurisë dixhitale dhe të ndërgjegjësimit për ngacmimin online, por ende nuk ka masa të detajuara për mekanizmat e raportimit. Në këtë kontekst, ka ende një boshllëk në kornizën ligjore për të siguruar rregulla të qarta për këtë çështje.

Aktualisht, nuk ka një program të qartë dhe gjithëpërfshirës të dedikuar për edukimin e nxënësve dhe stafit mbi sigurinë dixhitale dhe pasojat e cyberbullying-ut.

Megjithatë, Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2023-2027 përfshin masa për ngritjen e kapaciteteve në sigurinë kibernetike, duke zhvilluar kurse bazike për sigurinë online për nxënësit e shkollave të mesme. Këto trajnime mund të ndihmojnë në adresimin e fenomenit të ngacmimit online, por nuk përfshijnë një program specifik për cyberbullying në nivelin parauniversitar apo ende nuk ka filluar të bëhet diçka në këtë drejtim.

Privatësia dhe siguria e të dhënave të nxënësve mbikëqyret nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike. Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale garanton mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve dhe ndalon keqpërdorimin e tyre nga institucionet arsimore. Megjithatë, nuk ka udhëzime specifike se si shkollat duhet të trajtojnë të dhënat e nxënësve në kontekstin e përdorimit të teknologjisë për mësim. Për më tepër, Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2023-2027 parashikon ngritjen e kapaciteteve për sigurinë dixhitale, por ende nuk ka mekanizma të qartë për të mbrojtur privatësinë e nxënësve gjatë përdorimit të platformave dixhitale në arsim.




Rekomandime për shkollat

- **Zhvillimi i politikave shkollore për parandalimin dhe raportimin e ngacmimit online** - Shkollat duhet të krijojnë dhe zbatojnë udhëzime të qarta për parandalimin dhe raportimin e rasteve të bullizmit kibernetik, duke përfshirë masa disiplinore dhe mbështetje psikologjike për viktimat.
- **Trajnime për mësime dhe nxënës mbi sigurinë dixhitale** - Organizimi i sesioneve të rregullta për ndërgjegjësimin mbi sigurinë në internet, mbrojtjen e të dhënave personale dhe pasojat e ngacmimit online.
- **Fuqizimi i mekanizmave të raportimit dhe mbrojtjes së privatësisë** - Krijimi i kanaleve anonime për raportimin e rasteve të bullizmit online dhe sigurimi që të dhënat e nxënësve të trajtohen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- **Përfshirja e prindërve për një mjedis të sigurt mësimor** - Zbatimi i filtrave të sigurisë në rrjetet shkollore, sigurimi që platformat online të përdorura në mësim të respektojnë standardet e privatësisë dhe organizimi i takimeve dhe trajnimeve për prindërit mbi sigurinë në internet dhe sjelljen e fëmijëve online.

Kjo do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbikëqyrjes së sjelljes së fëmijëve në hapësirat digjitale.

Rekomandime për Drejtorinë e Edukimit

- **Hartimi dhe zbatimi i një strategjie të qartë për parandalimin e bullizmit kibernetik** - DKA duhet të udhëzojë shkollat për zhvillimin e politikave anti-bullizëm, duke përfshirë qasje të standardizuara për trajtimin e rasteve. Përditësimi i rregulloreve shkollore për të përfshirë qartë dispozitat kundër ngacmimit online dhe sigurimi që të gjitha shkollat zbatojnë një protokoll të unifi kuar për trajtimin e rasteve të ngacmimit online.
- **Angazhimi i psikologëve dhe sigurimi i trajnimeve të detyrueshme për stafi n arsimor mbi sigurinë dixhitale** - Në shumicën e shkollave të mesme në Mitrovicë mungojnë psikologët shkollorë – një boshllëk thelbësor që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien emocionale dhe psikologjike të nxënësve. Organizimi i programeve të trajnimit për mësime dhënësit dhe administratorët e shkollave mbi sigurinë në internet, rregulloret ligjore dhe praktikat e mbrojtjes së të dhënave.
- **Mbikëqyrja dhe zbatimi i standardeve të privatësisë në shkolla** - DKA duhet të sigurojë që shkollat të zbatojnë Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të respektojnë udhëzimet e Agjencisë për Informim dhe Privatësi për mbrojtjen e të dhënave të nxënësve.
- **Krijimi i një platforme komunale për raportimin dhe adresimin e rasteve të bullizmit online** - Zhvillimi i një mekanizmi efektiv për raportimin e rasteve të ngacmimit online, ku nxënësit, prindërit dhe mësime dhënësit mund të paraqesin shqetësimet e tyre në mënyrë të sigurt dhe anonime.



Prishtinë, 2025